

Në shërbim të Kosovës

E shkelin me këmbë gjithë territorin e Kosovës. Këtë e bëjnë pjesëtarët e FSK-së nga Njësia Ndërlidhëse e Reagimit, të cilët e verifikojnë çdo cep të vendit për të dhënë informacione të sakta në momentet kur paraqitet rreziku... Këta pjesëtarë janë krenarë për punën që bëjnë...

Anita Kadriu

PRISHTINË → Hapi i parë për të siguruar dhe për të mbrojtur jetën e qytetarëve të Kosovës në situata krize hidhet nga ta. Këta janë 40 pjesëtarët e Njësies Ndërlidhëse të Reagimit në Kriza (NRK) që veprojnë në kuadër të Forcave Mbrojtëse të Kosovës (FSK). Për t'u përgjigjur në nevojat e çdo kosovari, ata e shkelin në këmbë çdo copë toke të Kosovës. Hartat janë të vendosura në çdo zyrë të tyre, duke filluar nga ajo e komandantit të Njësies, nënkolonel Shemsi Sylja, pastaj në zyrën që quhet Dhoma e Kuqe ku qëndron pjesa tjetër e stafit prej pesë anëtarësh. Edhe në këtë zyrë hartat ajrore, tokësore, të tërmeteve, të pikave ujore... gjenden të vendosura në mure, të dhuruara nga trupat paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë. Por, 40 "lajmëruarit e rrezikut" për qytetarët nuk mjaftohen vetëm me këto harta. Ata ecin nëpër territorin e Kosovës që të kenë informata për çdo rrugë, kthesë, shkëmbinj... Kosova me të gjitha vendbanimet e saj, numrin e banorëve, rrugëve, shtëpive... është e vendosur në dosje që qëndrojnë në zyrën e stafit të kësaj njësie. Këto të dhëna nuk janë vjetore, përtërhen çdo tre muaj. Rishitë nëpër vendbanime shënohen, trupat e të gjitha njësive të FSK-së duhet të njoftohen nga ata të NRK-së saktë për çdo pëllëmbë dhe jo me hamendje. Kjo është moto e kësaj njësie: përçjella e informacioneve saktë deri te nivelet qendrore të shtetit në rast të krizave.

Mobilizimi për të shpëtuar jetë

Pasaktësinë thonë njëzëri se nuk mund ta tolerojnë. Varet jeta e njeriut nga ndihma e tyre. Kjo thonë se i bën të fortë dhe të pakthyeshmë edhe aty ku shihen pak mundësi për të depërtuar. Në zyrën e stafit qëndron i vendosur "territori i Kosovës" në miniaturë mbi një tavolinë ku është vendosur dhe di sipër malet, rrugët, vendbanimet ku duhet ndërhyrë, lehtë për t'u mbuluar dhe për t'u prekur me dorë njeriut, lëvizur sipas rasteve dhe lokacionit. Por, jo lehtë për t'u shkelur dhe për t'u identifikuar çdo vend Kosovë në realitet. E pavarësisht kësaj këta pjesëtarë e bëjnë këtë.

Ky përkushtim, sipas tyre, nuk shkohet kot. Dimri i sfidoi. Ditët e acarit në Kosovë ata shkelën të parët në zonat rurale-malore të izoluar nga bora dhe ortekët.

Saktësuan vendbanimet e izoluar, dhanë informacionet në bazë, u nisën njësitet e kërkim-shpëtimimit, xhenios... u zhbllkuan rrugë, u kthye energjia elektrike, u dha ndihma mjekësore... qytetarët u shpëtuan.

E nxorën Amsera Rekën në Restelice. Anëtarët e familjes së saj u varrosën... por, për të arritur deri tek ata u desh të bënin pesë kilometër këmbë në stuhitë dhe borë. Ndonëse fituan edhe më shumë simpatinë e qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, këta pjesëtarë duan të jenë edhe më të përsosur.

FSK është e gatshme të jetë në shërbim të qytetarit, por i duhen ende mjete dhe pajisje, pasi me këto aktuale rrezikohet të mos përmbushen gjithë kërkesat që mund të dalin nga terreni, megjithëkëtë pjesëtarët e NRK-së nuk ankohen.

Të mërkurën, ora 08:00 e mëngjesit të gjithë janë në bazë, pas 15 minutash do të fillojnë ushtrimet trupore - të ashtuquajtura detyra për kondicion, për të vazhduar më pas me rreshtimin dhe verifikimin para objektit të Njësies së tyre asaj për Ndërlidhëse dhe Reagimit në Kriza. Këta janë 40 pjesëtarët e kësaj njësie që çdo ditë kryejnë obligimet për të qenë në gjendje t'i përgjigjen detyrës kur i thërret, si verifikimit të gjendjes, analizimit të rrethave për të përcjellur në FSK, pastaj në ministri dhe qeveri gjenden në vendin ku është paralajmëruar rreziku.

Të profesionalizuar dhe humanë

Pasaktësia mund t'u kushtojë me jetë qytetarëve. E këta pjesëtarë thonë se janë të vetëdijshëm për këtë dhe nuk tolerojnë gabimet. Prandaj, sipas komandantit të njësies, nënkolonel Shemsi Sylja, përgjegjësia është prezenzë çdo ditë.

Të themeluar që para tri vjetësh pas transformimit të TMK-së, si njësi në kuadër të FSK-së, e para në rajon e këtij lloji, Sylja thotë se janë bërë planifikime, janë ndërmarë veprime, është investuar, kanë fituar përkrahje ndërkombëtare... që të jenë më të përsosur. Ai thekson se çdo pjesëtar i kësaj njësie ka kaluar dhe kalon nëpër shkollim, trajnime rajonale e ndërkombëtare dhe prapë rikthehet në bazë me dije dhe ushtrime të reja. "Kjo na dëshmoi dhe në rastet e dimrit që kaluam. Arritëm të përfshijmë



gjithë territorin ku u pa rreziku. Lajmëruar bazën dhe FSK-ja me trupat e saj adekuata për situatën doli në ndihmë të qytetarëve. Shumë rrugë, fshatra të Kosovës në Malësinë e Gollakut, Mallet e Berishës, Kaçanik, Dragash, Shtërpçë, Lipjan, Graçanicë... u liruara nga bora", thotë Sylja, sipas të cilit në kohë alarmi-rreziku për banorët, për pjesëtarët e kësaj njësie nuk ka orar të fillimit të punës dhe as mbarim. "Në këto situata ne punojmë pa ndërprerë". Edhe 50 nxënës të shkollës fillore "Hasan Prishtina" dhe studentët të Fakultetit të Shkencave Sportive morën ndihmën e FSK-së gjatë izolimit në shkurt në Brezovicë. Ndonëse nuk kishte rrezik për ata se ishin akomoduar në hotel ku kushtet nuk mungonin, ishte paniku që u shpërnda në mesin e nxënësve. Sylja shpjegon se rrugës për t'i sjellë në shtëpi rreziku ishte permanent, mirëpo, secili nxënës rrugës shoqërohej nga një pjesëtar i FSK-së. Ai tregon dhe anën tjetër të pjesëtarëve të kësaj njësie, të cilët duhet të jenë dhe psikolog në situata të ndryshme duke treguar afërsi, mirëkuptim për të qetësuar qytetarët dhe jo vetëm për të ndihmuar ata.

Të të gjitha etnive, për të gjithë

Pjesëtarët e FSK-së gjatë vizitave të territorit nuk harrojnë

ata që vunë bazën e institucioneve që përfaqësojnë sot. Janë memorialët e dëshmorëve që vizitohen nga pasardhësit e tyre-pjesëtarët e FSK-së. Këta pjesëtarë nuk harrojnë sakrificën për sigurinë dhe mbrojtjen e kosovarëve në kohë gjenocidi nga pjesëtarët e UÇK-së.

Kazerma ku janë të vendosur mban emrin e heroit "Adem Jashari". Nënkoloneli Sylja, dikur ish-zëvendëskomandant i Zonës së Karadakut në UÇK, thekson se kjo njësi me përgjegjësi po prek standardet ndërkombëtare dhe po profesionalizohet çdo ditë dhe më shumë.

Kjo njësi e cila përbëhet nga tri ekipe, po ndjek përvojat ndërkombëtare në situata krizash nga dy mentorë danezë. Sipas Sylës, pjesëtarët e kësaj njësie kanë përfituar përkrahje nga qeveria daneze e cila u mundësoi një trajnim në fund të marsit dhe fillimit të prillit... dha donacione dhe i pajisi me shumë mjete tjera. Por, edhe nga qeveritë tjera përëndime kjo njësi pati përkrahje. Në një nga hapësirat e objektit të kësaj njësie është e vendosur edhe biblioteka që numëron mbi 6 mijë ekzemplarë të librave me përmbajtje ushtarake, politike, strategjike, historike, gjeografike, letërsi...

në gjuhë të ndryshme. Aty është këndi amerikan i librave, gjerman, danez... Pjesëtarët e FSK-së marrin në shfrytëzim tash këto libra.

Tetari Agron Murati që punon në këtë bibliotekë, thekson se kësaj bibliotekë do t'i shtohen edhe pesë mijë ekzemplarë të tjerë librash për të arritur deri mbi dhjetë mijë ekzemplarë totali. Kjo bibliotekë tani mund të shfrytëzohet nga të gjithë pjesëtarët e FSK-së. NRK-ja ka në përberje të saj dy pjesëtarë të gjinisë femërore dhe dy pjesëtarë nga komunitetet.

FSK-ja në ditët e acarit dëshmoi se është në gjendje për të intervenuar në shpëtimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Njësitet e FSK-së intervenuan edhe në zonat e banuara me shumicë nga komunitetet.

Major Milaim Musliu thekson se për të dhe kolegët e tij nuk ka rëndësi përkatësia etnike, përkundrazi ai përmend se kudo që duhet të jenë prezentë e bëjnë këtë të kapluan nga ndjenja për të shpëtuar jehim të njerëzish dhe "duke vënë veten (jetën) tonë përballë rreziqeve për të shpëtuar qytetarët kosovarë". Pjesëtarët e FSK-së janë pjesëmarrës edhe në takimet lokale nëpër komuna ku japin kontributin e tyre në shumë fusha të sigurisë.